



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 072/12
Prishtinë, më 29 maj 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 MAJ 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 73 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amandamentimin e rendit të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtim i dytë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore

Kryetari njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit nga seanca e paradites, Komisionet parlamentare, kanë shqyrtuar Projektligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore. Komisioni funksional ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Gani Koci paraqiti raportin dhe arsyetoi amendamentet e paraqitura. Ai kërkoi që Kuvendi ta miratojë këtë projektligj me amendamentet e propozuara.

Kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për81,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**